



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 51.1 dhe 52.1, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neneve 4, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.03/2014 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunë, si dhe neneve 14, 45.1 dhe 46.1 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2018, mori,

VENDIM

PËR THEMELIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Neni 1

Themelohet Komiteti për Politikë dhe Financa – KPF i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në këtë përbërje:

1. **Fatmir Gashi**, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht Kryesues i KPF-së
2. **Mehmet Gashi**, anëtar nga radhët e LDK-së
3. **Fatlume Jaha**, anëtare nga radhët e LDK-së
4. **Arlinda Kadriu**, anëtare nga radhët e LDK-së
5. **Avni Fetahu**, anëtar nga radhët e LDK-së
6. **Fitim Haziri**, anëtar nga radhët e LVV-së
7. **Adelinë Stublla**, anëtare nga radhët e LVV-së
8. **Rafet Llapashtica**, anëtar nga radhët e PDK-së
9. **Floretë Zejnullahu**, anëtare nga radhët e PDK-së

Neni 2

Mandati i anëtarëve të Komitetit sipas nenit 1 të këtij vendimi, ndërlidhet dhe është në kohëzgjatje të mandatit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, ndërsa ndryshimi dhe plotësimi eventual, bëhet me vendim të veçantë nga Kuvendi i Komunës.

Neni 3

Komiteti për Politikë dhe Financa, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.03/2014 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunë, Statutin e Komunës, Rregulloren e punës së Kuvendit, dhe dispozitat tjera përkatëse në fuqi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 8.11 të Rregullores (QRK) nr.01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr. 01-020/02-0014914/18
Podujevë,
28 shkurt 2018

